



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PRRENJAS

Nr. _____ prot.

Prrenjas, më _____.2024

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Për pranimin në Shërbimin e MZSH-së (sektori për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, Bashkia Prrenjas)

KREU I-Pranimi në Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi

Në zbatim të Ligjit nr.152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” Kreu III, neni 14,pika 1 “Kriteret e pranimi në nivelin bazë të shërbimit të MZSH-së” dhe neni 15 “Emërimi ,lirimi dhe përjashtimi i personelit të Shërbimit të MZSH-së”; Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Prrenjas nr. 15, datë 27.12.2023 me nr 72 prot datë 05.01.2024 “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë, institucioneve në varësi dhe njërive administrative për vitin 2024”; Kërkesë nr. 115 prot datë 19.06.2024 protokolluar me tonën me nr. 1737/1 prot datë 20.06.2024 “Kërkesë”, Bashkia Prrenjas njofton se në Sektorin e MZSH-së ka 1(një) vend të lirë pune në nivelin bazë të këtij shërbimi në pozicionet e mëposhtme:

1. Asistent Zjarrfikës

KREU II-Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës

Shërbimi i MZSH-së është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, misioni i të cilës është inspektimi, parandalimi me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidenteve të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkatuara nga dora e njeriut. Zjarrfikësi është personi i emëruar në strukturat e shërbimit të MZSH-së, i trajnuar profesionalisht për të ndërhyrë në shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin e jetës së njeriut, të gjësë së gjallë dhe pronës. Duhet të njoh dhe te zbatoje orarin e veprimeve, të dije pozicionin në shërbim dhe detyrat e tij funksionale, të jetë në cdo kohë në gadishmëri të lartë për të vepruar në zgjidhjen e situatave që ndodhin, të njoh dhe të zbatojë rregullat e brendshme në stacion dhe të sigurojë paprekshmërinë dhe abuzimin e mjedisëve, teknikës, paisjeve etj, të mbajë pastër të gjitha ambjentet që disponon stacioni, të jetë i sjellshëm në komunikim me qytetarët që kërkojnë ndihmë, me kolegët duke pasqyruar një figurë qytetare dhe humane.

Kërkesa të Përgjithshme për pranimin:

1. Të jetë shtetas shqipëtar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në gjendje të mirë shëndetësore dhe i/e aftë për të kryer detyra me rrezik të shtuar;
4. Të mos jetë i përjashtuar nga shërbimi zjarrfikës, Policia e Shtetit apo nga institucione të tjera;
5. Të ketë mbaruar arsimin e mesëm;
6. Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale me dashje;
7. Të jetë nën moshën 30 (tridhjetë) vjeç;
8. Të jetë i gjatë, jo më pak se 1.70;
9. Të ketë përfunduar testimin fiziko-profesional dhe kursin përkatës pranë Akademisë së Sigurisë osë në qendra të trajnimit zjarrfikës.

KREU III-Dorëzimi i dokumenteve, kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi, pranë Njësisë Përgjegjëse, Bashkia Prrenjas këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim drejtuar institucionit të Bashkisë (sektorit të shërbimit të MZSH-së) ;
2. Fotokopje e ID (kartë identiteti);
3. Çertifikatë familjare;
4. Një kopje të jetëshkrimit(CV);
5. Një numër kontakti (e-mail) si dhe adresën e plotë të vendbanimit;
6. Diplomë të njësuar me origjinalin të arsimit të mesëm(minimalisht);
7. Listë notash të njësuar me origjinalin;
8. Raport mjeko-ligjor nga autoriteti kompetent, që vërteton “gjëndje të mirë shëndetsore dhe i/e aftë fizikisht për të kryer detyra me rrezik të shtuar”;
9. Referencë me karakteristika specifike nga punëdhënësi i fundit (nëse ka);
10. Vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, si dhe nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor;

11. Fotokopje të librezës së punës e njësuar me origjinalin (nëse ka);
12. Çertifikata, trajnime profesionale, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (nëse ka);
13. Formulari i aplikimit (plotësimi i të cilit bëhet pranë zyrës së menaxhimit të burimeve njerëzore, Bashkia Prrenjas).

Në datën 26.06.2024, do të shpallet lista e verifikimit paraprak të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin (në faqen zyrtare të Bashkisë, Shërbimin Kombëtar të punësimit dhe në stendën e informimit të publikut). Këta do të jenë kandidatët që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e aplikimit, të kërkuara më sipër.

Kandidatet e kualifikuar në lidhje me dokumentacionin e paraqitur do të njoftohen në mënyrë elektronike /email-mesazh, për datën, vendin dhe orën e zhvillimit të procedurave (Testimin me shkrim, Testin fizik dhe Intervistën me gojë).

Kandidatët e pa kualifikuar do të njoftohen në mënyrë elektronike /email-mesazh për arsyet e mos kualifikimit, ata kanë të drejtë të ankohen në njësinë përgjegjëse, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit dhe të shpalljes së listës dhe ankuesi merr përgjigje, brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të saj.

Fusha kryesore mbi të cilën bazohet konkurimi

- ❖ Njohuritë për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e azhornuar
- ❖ Ligjin nr.139/2015, date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- ❖ Ligji nr.152, datë 21.12.2015 ‘Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin’.
- ❖ Rregulloren në fuqi të funksionimit të shërbimit të MZSH-së

Procedura e konkurimit do të vazhdojë në tre faza:

1: Provimi me shkrim do të bëhet **në datën 27.06.2024**, në mjediset e Bashkisë Prrenjas në orën **10-00**.

2. Testi i aftësive fizike: i cili përmban, vrapim, peshën/gjatësi dhe testimet e muskujve, do të zhvillohet **në datën 28.06.2024** në mjediset e Sektorit të MZSH-së, në orën 12-00.

3. Intervista me gojë do të zhvillohet në datën **në datën 28.06.2024**, në mjediset e Bashkisë Prrenjas në orën 10-00.

Kandidatët do të vlerësohen nga “Komisioni i Brendshëm”, i ngritur pranë Bashkisë Prrenjas. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatit është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht: 50 (pesëdhjetë) pikë për testimin me shkrim, 25 (njëzetë e pesë) pikë për intervistën me gojë dhe 25 (njëzetë e pesë) pikë për testin fizik.

Kandidati do të konsiderohet i sukseseshem nëse merr mbi 70 pikë.

Lista përfundimtare e kandidatëve të përzgjedhur fitues: do të shpallet në faqen zyrtare të Bashkisë Prrenjas, Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe në stendën e informimit të publikut.

Kandidatët e pa kalifikuar kanë të drejtë të ankohen në njësinë përgjegjëse, brenda 5 ditëve nga njoftimi dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të saj.

Kandidati fitues do të renditen sipas numrit të pikeve të marra dhe përzgjedhja e kandidatëve për tu emëruar do të filloj nga kandidati fitues që ka marre më shumë pikë.

Njoftimi i fituesit do të shpallet pas përfundimit të afatit të ankimimit .